



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 138

Tiranë – E enjte, 29 qershor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 44, datë 19.6.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 45, datë 26.2.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër, dhe nr. 00-2015-2466(158), datë 7.10.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	6863
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 83, datë 7.6.2017	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e Draftregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit; Marrëveshjes së operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit, si dhe Marrëveshjes së lidhjes në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit.....	6867
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 84, datë 7.6.2017	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Diteko” sh.p.k. për barrësimin e aseteve të kompanisë (pajisjet elektromekanike) në favor të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a.....	6867
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 85, datë 7.6.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	6869
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 86, datë 7.6.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.....	6870
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 87, datë 7.6.2017	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Kurum International” sh.a. në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike.....	6871
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 88, datë 7.6.2017	Mbi miratimin e kërkesës për lënien peng të aseteve të shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., në favor të bankave “Green For Growth Fund Southeast Europe SA (GGF)” dhe “Oesterreeichische Entwicklungsbank Ag (OeEB)”.....	6872
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 90, datë 7.6.2017	Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për periudhën 5.1.2017 - 20.9.2017.....	6873



VENDIM
Nr. 44, datë 19.6.2017
NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 22.5.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 17 Akti, që i përket:

KËRKUES: Skënder Haziraj

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 45, datë 26.2.2015 të Gjykatës së Apelit Shkodër, dhe nr. 00-2015-2466(158), datë 7.10.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1 dhe 42/2, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1/5 dhe 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 4 i protokollit nr. 7 të Konventës; nenet 27, 28, 29, 30, 39, 42 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të përfaqësuesit të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuar është gjykuar dhe dënuar në mungesë nga gjykatat serbe. Në kuadër të

ekzekutimit të vendimit penal, autoritetet serbe kanë kërkuar ekstradimin e kërkuarit duke i bashkëngjitur kërkesës certifikatën e shtetësisë serbe të kërkuarit, si dhe dokumentacionin e identifikimit të kërkuarit, bashkë me dokumentet që vërtetojnë dënimin e tij penal. Në këto kushte, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës ka kërkuar para gjykatës miratimin e ekstradimit dhe mbajtjen në paraburgim të kërkuarit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. 71, datë 3.10.2014, ka vendosur: *“Refuzimin e ekstradimit nga Republika e Shqipërisë drejt Republikës së Serbisë të shtetasit kosovar Skënder Haziraj. Heqjen e masës së sigurisë arrest në burg. Lirimin e menjëhershëm të shtetasit Skënder Haziraj”*.

3. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 45, datë 26.2.2015, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 71, datë 3.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Miratimin e ekstradimit të të kërkuarit Skënder Haziraj”*.

4. Kundër këtij vendimi, kërkuar ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Me vendimin nr. 00-2015-2466(158), datë 7.10.2015, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 45, datë 26.2.2015 të Gjykatës së Apelit Shkodër”*.

II

5. **Kërkuar** i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimeve të marra dhe parashtron në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe:

5.1 Kërkuar nuk është shtetas serb, por shtetas kosovar, ndryshe nga sa parashikon vendimi i gjykatave serbe dhe, për këtë arsye, nuk duhet të vendoset ekstradimi i tij në Republikën e Serbisë.

5.2 Nga dokumentet e paraqitura prej autoriteteve serbe është vetëm një vendim gjyqësor, gjë që nuk lë të kuptohet se çështja është gjykuar në të tria shkallët.

5.3 Nga vendimi i gjykatave serbe nuk rezulton nëse kërkuar ka qenë i përfaqësuar nga avokat, pasi është gjykuar në mungesë.

5.4 Kolegji Penal duhej të kishte marrë parasysh se gjykatat nuk e kanë interpretuar drejt ligjin dhe se kërkuar duke qenë se ka shtetësi kosovare, ekstradimi i tij është rrethënë rënduese ndaj autoriteteve serbe, ndaj të cilave kërkuar ka pasur aktivitet të njohur si ish-luftëtar i UÇK-së.



6. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme*, ka prapësuar me shkrim para Gjykatës, në mënyrë të përmbledhur, sa më poshtë vijon:

6.1 Pretendimet e kërkuarit janë të pabazuara, pasi ai nuk është dënuar për vepra penale të natyrës politike dhe si rrjedhim nuk ka asnjë tregues se ai do të diskriminohet për këtë shkak. Ai është gjykuar dhe dënuar për kalim të paligjshëm të kufirit dhe trafikim të qenieve njerëzore.

6.2 Nuk qëndron as pretendimi se ai nuk është mbrojtur me avokat gjatë gjykimit. Përkundrazi, nga vendimi gjyqësor rezulton se ai është mbrojtur nga një avokat, i cili madje ka kërkuar edhe ndryshimin e cilësimit të veprës penale, duke realizuar një mbrojtje efektive.

6.3 Pretendimet e kërkuarit në tërësi janë të natyrës ligjore dhe lidhen me interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme për sa i takon plotësimin ose jo të kushteve për të vendosur ekstradimin e një shtetasi të huaj. Në këto kushte, ai nuk mund të kërkojë nga kjo Gjykatë interpretimin e gabuar të ligjit, pasi nuk është në juridiksionin e kësaj Gjykate.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

7. Gjykata vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e tij, të cilat i ka paraqitur në kërkesë, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Kërkuari legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion.

B. Për pretendimin se vendimi për ekstradimin e tij është i pabazuar

8. Sipas kërkuarit, duke qenë se ai është shtetas kosovar dhe jo serb, si dhe nisur nga fakti se Republika e Serbisë nuk e njeh Republikën e Kosovës, gjykatat shqiptare nuk duhej të kishin vendosur ekstradimin e tij, pasi ekzistojnë mundësitë që ai t’i nënshtrohet një diskriminimi dhe trajtimi rëndues për shkak të shtetësisë së tij dhe angazhimit të tij në forcat ushtarake të ish-

UÇK-së gjatë periudhës së shkëputjes së Kosovës nga ish-Jugosllavia.

9. Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, ajo nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131/1/f të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues (*shih vendimin nr. 16, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 16, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Në këtë kuptim, Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar e riparuar nga Gjykata e Lartë. Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19, datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).



12. Duke iu referuar çështjes konkrete për shqyrtim, Gjykata, bazuar në dosjen gjyqësore, vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë të Republikës së Serbisë është depozituar në origjinal (në gjuhën serbe) dhe e përkthyer zyrtarisht në gjuhën shqipe. Nga vendimi i Gjykatës së Lartë të Republikës së Serbisë rezulton se kërkuesi është gjykuar dhe dënuar për veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore dhe kalimit të paligjshëm të kufirit, parashikuar nga nenet 350/3 dhe 61 të Kodit Penal serb, të kryer në bashkëpunim me 19 të pandehur të tjerë, në formën e një organizate kriminale. Në përfundim të gjykimit, Gjykata ka konsideruar se kërkuesi ka qenë një nga organizatorët e grupit, gjë e cila është vlerësuar si rrethanë rënduese (shih faqen 226 të dosjes gjyqësore). Gjykata e Lartë serbe ka analizuar se kalimi i paligjshëm i kufirit të shtetit të Serbisë dhe Malit të Zi (vepra penale i referohet periudhës para shkëputjes së Malit të Zi nga Republika e Serbisë dhe Malit të Zi) është bërë nëpërmjet Novi Pazarit deri në Beograd dhe më tej i kanë shoqëruar shtetasit e huaj, objekt trafikimi, deri në kufi me Kroacinë dhe Hungarinë (shih faqet 191-196 të dosjes). Në trafikim janë përfshirë edhe shtetas nga Shqipëria, të cilët kalonin nëpër të njëjtën rrugë. Pra, edhe nga vendimi i Gjykatës serbe rezulton se kërkuesi e ka kryer veprën penale në territorin e Serbisë dhe Malit të Zi.

13. Gjithashtu, Gjykata konstaton se lidhur me procedurën e ekstradimit të zhvilluar në shtetin shqiptar, rezulton se pranë Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë ka ardhur një kërkesë nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Serbisë dhe në përgjigje të saj, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme për të vepruar konform Konventës Europiane për Ekstradimin, Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit nr. 10193/2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë”. Në këto kushte, prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka vlerësuar të gjitha kushtet ligjore që duhet të plotësojë një kërkesë për ekstradim dhe ka konkluduar se: a) nuk ka të dhëna se Republika e Serbisë do t’ia dorëzojë kërkuesin S.H. ndonjë shteti tjetër; b) shtetasi S.H. nuk ndiqet për një vepër penale me karakter politik, por për kalim të paligjshëm të kufirit dhe trafikim

të qenieve njerëzore; c) nuk ka të dhëna që do t’u nënshtrohet persekutimeve apo diskriminimeve për shkaqe të tilla, si: feja, seksi, shtetësia, gjuha, bindjet politike etj.; ç) shtetasi S.H. nuk ka kryer vepra penale në Shqipëri; d) veprat penale për të cilat akuzohet S.H. parashikohen si të dënueshme edhe nga legjislacioni shqiptar; dh) nuk është dhënë amnisti nga shteti shqiptar për këto vepra; e) personi i kërkuar nuk është shtetas shqiptar, por i huaj; ë) nuk është parashikuar vepra penale për të cilën ai është dënuar.

14. Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se me të drejtë prokuroria ka arritur në përfundim se kushtet që parashikon Konventa Europiane për Ekstradimin dhe legjislacioni i brendshëm shqiptar janë të plotësuar dhe nuk ka asnjë pengesë për të lejuar ekstradimin. Përveç sa më sipër, Gjykata thekson se autoritetet shqiptare kanë detyrimin që të zbatojnë edhe detyrimin që rrjedh nga Konventa Europiane për Ekstradimin, e cila është ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998. Gjykata vëren se gjatë ratifikimit të kësaj Konvente shteti shqiptar ka mbajtur si rezervë, pra nuk ka pranuar të ekstradojë shtetasit e saj (shtetasit shqiptarë), me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë (neni 2/2 i ligjit). Këtu përfshihen edhe shtetasit që kanë dyshtetësi, njëra prej të cilave është shqiptare (neni 2/3 i ligjit). Kërkuesi nuk është shtetas shqiptar, por i huaj. Në këto kushte, Republika e Shqipërisë nuk mund ta refuzojë shtetasin e huaj, nëse nuk ka arsye të besueshme se ai do t’u nënshtrohet trajtimeve diskriminuese apo do të vuajë dënime të bazuara në motive politike, apo shkaqe të tjera të ndaluara nga konventat, apo legjislacioni kombëtar për çështjen e ekstradimit.

15. Gjykata vëren se edhe Republika e Serbisë e ka ratifikuar këtë Konventë në datën 30.9.2002. Pra, të dyja palët janë në kushtet që duhet të plotësojnë detyrimet e Konventës për ekstradimin e personave të dënuar për vepra penale të kryera në territorin e tyre, pavarësisht shtetësisë. Konkretisht, neni 1 parashikon: “*Palët kontraktuese zotohen t’i dorëzojnë njëra-tjetrës, sipas rregullave dhe kushteve të përcaktuara në nenet që vijojnë, individët që ndiqen për shkelje të ligjit ose kërkohen nga organet gjyqësore të palës kërkuese për të vuajtur dënimin*”



ose masën e sigurimit?'. Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit e vetë palës së cilës i drejtohet kërkesa, gjë që është përjashtuar edhe nga ligji ratifikues i Konventës.

16. Si përfundim, Gjykata, nisur nga analiza e mësipërme, vlerëson se kërkuesi nuk paraqiti asnjë argument të nivelit kushtetues se kërkesa për ekstradim është vlerësuar në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe konventor, si nga Gjykata e Apelit Shkodër, ashtu edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

C. Për pretendimin se kërkuesi nuk ka realizuar të drejtën e mbrojtjes para gjykatave serbe

17. Kërkuesi pretendon se duke qenë se është gjykuar në mungesë, ai nuk ka realizuar të drejtën e mbrojtjes gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar ndaj tij nga gjykatat serbe dhe për këtë shkak procesi ka qenë i parregullt.

18. Gjykata vlerëson se nuk është në juridiksionin e saj të vlerësojë dhe të mbajë qëndrim ndaj pretendimeve për shkelje procedurale gjatë proceseve gjyqësore të gjykatave të huaja. Një gjë e tillë mund të bëhet nga vetë kërkuesi në rrugën e rishikimit të vendimeve gjyqësore apo rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit, sipas legjislacionit procedural të shtetit serb, vendimi i të cilit ka marrë formë të prerë dhe është në fazën e ekzekutimit. Pavarësisht këtij qëndrimi, Gjykata e sheh të arsyeshme të theksojë se pretendimi nuk rezulton të jetë i bazuar, pasi në vendimin e Gjykatës serbe përmendet fakti se kërkuesi i është caktuar një mbrojtës kryesisht, i cili rezulton të ketë kryer përfaqësimin dhe mbrojtjen konform rregullave procedurale, duke kërkuar edhe ndryshimin e cilësimit të veprës penale, gjë që dëshmon për një mbrojtje efektive.

Ç. Për pretendimin se Kolegji Penal nuk ka zbatuar drejt ligjin

19. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Apelit Shkodër ka zbatuar gabim ligjin dhe këtë gabim duhej ta kishte riparuar Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, si gjykata më e lartë.

20. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë Gjykata që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit, si dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj (*shih vendimin nr. 2, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata vlerëson se Kolegji Penal në arsyetimin e tij ka analizuar me detaje të gjitha kushtet e parashikuara në nenin 491 të KPP-së, që parashikon se në cilat raste nuk mund të ekstradohet një shtetas i huaj ose shqiptar. Në këtë kontekst, vendimi i Kolegjit Penal ka respektuar edhe standardin e arsyetimit të vendimit, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuetit lidhur me paligjshmërinë e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Apelit.

22. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se nga vendimet e kundërshtuara rezulton se Gjykata e Apelit dhe Kolegji Penal kanë arritur në përfundimin e shprehur në dispozitiv, pasi kanë marrë në shqyrtim dhe kanë analizuar të gjitha provat e administruara në gjykim, si dhe duke vlerësuar fuqinë provuese të secilës prej tyre. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs, duke mbajtur një qëndrim të shprehur lidhur me to. Për rrjedhojë, procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë nuk ngre dyshime për cenimin e elementeve të procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës.

23. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuetit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor janë të pabazuara, për rrjedhojë kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 71, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Fatos Lulo



VENDIM
Nr. 83, datë 7.6.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
MIRATIMIN E DRAFTRREGULLORES
SË PROCEDURAVE PËR LIDHJET E
REJA DHE MODIFIKIMIN E LIDHJEVE
EKZISTUESE ME RRJETIN E
TRANSMETIMIT; MARRËVESHJES SË
OPERIMIT NË RRJETIN E
TRANSMETIMIT NDËRMJET OST SHA
DHE PËRDORUESIT, SI DHE
MARRËVESHJES SË LIDHJES NË
RRJETIN E TRANSMETIMIT
NDËRMJET OST SHA DHE
PËRDORUESIT**

Në mbështetje të neneve 16, 21, 27 dhe 28 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; “Kodit të transmetimit”, miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 123, datë 31.10.2008, dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2017, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e “Rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit”, “Marrëveshjes së operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit”, si dhe “Marrëveshjes së lidhjes në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit”

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 2350 Prot., datë 28.4.2017, OST sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e “Rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit”, “Marrëveshjen e lidhjes”, si dhe “Marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit”.

- Kjo rregullore, si dhe marrëveshjet standarde të lidhjes bashkëlidhur saj bazohen në nenet 21, 27 dhe 28 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në Kodin e transmetimit, miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 123, datë 31.10.2008.

- Në nenin 27, pika 3 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” parashikohet se është OST sh.a. në cilësinë e të licencuarit, i ngarkuar me detyrimin e hartimit të kësaj rregulloreje dhe ERE ka autoritetin për miratimin e saj.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e “Draftrregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit”; “Marrëveshjes së operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit”, si dhe “Marrëveshjes së lidhjes në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a., si dhe palët e interesuara për vendimmarrjen e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 84, datë 7.6.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “DITEKO” SHPK PËR
BARRËSIMIN E ASETVEVE TË
KOMPANISË (PAJISJET
ELEKTROMEKANIKE) NË FAVOR TË
BANKËS KOMBËTARE TREGTARE SHA**

Në mbështetje të neneve 16; 44, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 6; 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të asetveve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 99, datë 17.6.2016, gjithashtu dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe



procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Diteko” sh.p.k., për barrësimin e aseteve të kompanisë (pajisjet elektromekanike) në favor të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Diteko” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gerमत:

-“a” Një ekstrakt historik i shoqërisë tregtare të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit: plotësuar.

-“b” Veprimtaria e licencuar: plotësuar. (Subjekti është i licencuar nga ERE në aktivitetet e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike.)

-“c” Gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve: plotësuar. (Subjekti ka paraqitur bilancin dhe pasqyrat financiare për vitin 2016.)

-“d” Një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim asetit, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare: Banka që do të barrësojë asetet e shoqërisë “Diteko” sh.p.k. është Banka Kombëtare Tregtare (BKT).

-“e” Arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit janë: Financimi i finalizimit të hidrocentraleve të shoqërisë “Diteko” sh.p.k. dhe/ose lëvrimin e letër-kredive për blerjen e turbinave të hidrocentraleve të “Diteko” sh.p.k., dhe/ose kontratave të furnizimit e blerjes për materiale/pajisje në funksion të ndërtimit të hidrocentraleve.

-“f” Efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit: Vendosja në operim e veprave në fund të vitit. Shpjeguar nga subjekti në kërkesën drejtuar ERE-s për barrësim.

-“g” Efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifën e aktivitetit të licencuar: pa plotësuar.

-“h” Marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen. Subjekti ka paraqitur si më poshtë:

Kontratën e kredisë bankare, nr. 1347 Rep., nr. 313 Kol., datë 3.3.2017, lidhur midis shoqërisë “Diteko” sh.p.k., dhe Bankës Kombëtare Tregtare sh.a.

-“i” Deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehet gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit: Nuk rezulton të jetë depozituar asnjë deklaratë ku të shprehet gatishmëria për të garantuar veprimtarinë e licencuar nga personi tek i cili është propozuar të bëhet transferimi.

-“j” Nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt: Nga përmbajtja e kontratës së kredisë bankare që subjekti “Diteko” sh.p.k. ka depozituar në ERE, subjekti në cilësinë e kredimarrësit kundrejt limitit total të kreditimit dhënë nga Banka Kombëtare Tregtare e siguron këtë të fundit me anë të garancisë përfaqësuar nga:

- Kontrata e hipotekës nr. 3538 Rep., nr. 910 Kol., datë 11.7.2014.

- Marrëveshja siguruuese (në formën e pengut mbi pajisjet dhe makineritë) nr. 2421 Rep., nr. 1416 Kol., datë 7.9.2015.

- Marrëveshje pengu mbi kredi/të drejta nr. 2437 Rep., nr. 1427 Kol., datë 8.9.2015.

- Marrëveshje siguruuese (në formën e pengut të të ardhurave të arkëtueshme) nr. 2438 Rep., nr. 1428 Kol., datë 8.9.2015.

- Kontrata e hipotekës nr. 5698 Rep., nr. 1097 Kol., datë 7.10.2015.

- Marrëveshje pengu mbi kredi/të drejta nr. 5693 Rep., 1092 Kol., datë 7.10.2015.

- Marrëveshje siguruuese (në formën e pengut të të ardhurave të arkëtueshme) nr. 5694 Rep., nr. 1093 Kol., datë 7.10.2015.

- Marrëveshje pengu (mbi kuotat e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar) nr. 5695 Rep., 1094 Kol., datë 7.10.2015.

- Marrëveshje pengu mbi kredi/të drejta nr. 4337 Rep., nr. 2332 Kol., datë 2.9.2016.

- Marrëveshje siguruuese (në formën e pengut të të ardhurave të arkëtueshme) nr. 4338 Rep., nr. 2333 Kol., datë 2.9.2016.



- Kontrata e hipotekës nr. 1348 Rep., nr. 314 Kol., datë 3.3.2017.

- Marrëveshja siguruese (në formën e pengut të të ardhurave të arkëtueshme) nr. 1351 Rep., nr. 317 Kol., datë 3.3.2017.

- Marrëveshje siguruese (mbi kuotat e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar) nr. 1350 Rep., nr. 316 Kol., datë 3.3.2017.

- Marrëveshje siguruese (në formën e barrës siguruese mbi makineritë dhe turbinat e hidrocentraleve të shoqërisë “Diteko” sh.p.k), të cilat do të nënshkruhen në një fazë të dytë me nënshkrimin e kësaj kontrate.

- Neni 7, pika 3. Subjektet koncesionare të licencuara, të cilat aplikojnë për miratimin e transferimit të asetëve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të asetëve detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncesionit e pjesët që transferojnë te përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Autoritetit Shtetëror në lidhje me qëllimin e transferimit të asetëve. Nuk rezulton nga dosja që subjekti të ketë depozituar në ERE miratimin e MEI-t për këtë barrësim asetesh.

Për mungesën e dokumentacionit të sipërcituar do të njoftohet subjekti që, në bazë të nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Diteko” sh.p.k. për lënien peng të asetëve që i shërbejnë aktivitetit për të cilin është licencuar, në favor të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 85, datë 7.6.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, nenit 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

konstatoi se:

Shoqëria “Albpetrol” sh.a., me shkresën nr. 3322/1 Prot., datë 11.5.2017, protokolluar në ERE me nr. 385/1 Prot., datë 12.5.2017, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Albpetrol” sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formatit i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “b”, “c” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8,



germat “a” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Vërtetimin nga Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë (neni 9, pika 2, germa “d”);

- Dokumentet që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit (neni 9, pika 3, germa “c”);

- Kapitalin financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti (neni 9, pika 4/8, germa “b”);

- Listën e kontratave të mëparshme, nëse ka pasur (neni 9, pika 4/8, germa “c”).

Do të njoftohet subjekti që, në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e tregutit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 86, datë 7.6.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALBPETROL” SHA NË AKTIVITETIN
E FURNIZIMIT TË ENERGIJË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d”; 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për

procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

konstatoi se:

Shoqëria “Albpetrol” sh.a., me shkresën nr. 3322/1 Prot., datë 11.5.2017, protokolluar në ERE me nr. 385/1 Prot., datë 12.5.2017, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Albpetrol” sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formatit i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “b”, “c” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “c” dhe “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Vërtetimin nga Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë (neni 9, pika 2, germa “d”);

- Dokumentet që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit (neni 9, pika 3, germa “c”);

- Kapitalin financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti (neni 9, pika 4/7, germa “b”);



- Listën e kontratave aktuale dhe të mëparshme për blerjen dhe sigurimin e energjisë elektrike (neni 9, pika 4/7, germa “c”;

- Të dhënat për klientët dhe energjinë e furnizuar (neni 9, pika 4/7, germa “a.1”);

- Nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes për klientët (neni 9, pika 4/7, germa “b.1”);

- Kapitalin financiar (*i shprehur në vlera monetare*) i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti (neni 9, pika 4/7, germa “c.1”).

Do të njoftohet subjekti që, në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 87, datë 7.6.2017

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë

29.6.2016, dhe nenit 15 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për rinovimin e licencës për shoqërinë “Kurum International” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

konstatoi se:

ERE, me vendimin nr. 69, datë 11.5.2017, filloi procedurën “Për rinovimin e licencës së shoqërisë “Kurum International” sh.a. në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike”.

Aplikimi i shoqërisë “Kurum International” sh.a. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “a.1”, “b.1” dhe “c.1”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Kurum International” sh.a. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 88, datë 7.6.2017

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS PËR
LËNIEN PENG TË ASETEVE TË
SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY”
SHPK, NË FAVOR TË BANKAVE
“GREEN FOR GROWTH FUND
SOUTHEAST EUROPE SA (GGF)” DHE
“OESTERREEICHISCHE
ENTWICKLUNGBANK AG (OEEB)”**

Në mbështetje të neneve 16; 44, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 7 dhe 11 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 99, datë 17.6.2016 të bordit të ERE-s, gjithashtu dhe neni 15 i “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi kërkesën e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., për lëniën peng të aseteve në favor të bankave “Green For Growth Fund Southeast Europe S.A(GGF)” dhe “Oesterreeichische Entwicklungsbank AG (OeEB)”, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

ERE, me vendimin nr. 143, datë 15.8.2016, ka filluar procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k. për lëniën peng të aseteve në favor të bankave “Green For Growth Fund Southeast Europe SA (GGF)” dhe “Oesterreeichische Entwicklungsbank AG (OeEB)”.

Aplikimi i shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit” si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, geramat:

- “a” Ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit, është plotësuar.

- “b” Veprimtaria e licencuar është plotësuar.

- “c” Gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve, është plotësuar.

- “d” Përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare, është plotësuar.

- “e” Arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit, është plotësuar.

- “f” Efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit, është plotësuar.

- “g” Efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifën e aktivitetit të licencuar, është plotësuar.

- “h” Marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji për transferimin e aseteve. Marrëveshja përmban një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen, është plotësuar.

- “i” Deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit, është plotësuar.

- “j” (Nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt) është e paplotësuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k. për lëniën peng të aseteve në favor të bankave “Green For Growth Fund Southeast Europe SA (GGF)” dhe “Oesterreeichische Entwicklungsbank AG(OeEB)” (lista bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



ASETE TË SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SHPK PËR LËNIEN PENG NË FAVOR TË BANKAVE “GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEAST EUROPE SA (GGF)” DHE “OESTERREEICHISCHE ENTWICKLUNGBANK AG (OEEB)”

(I) Një digë ujëmbledhëse me gjerësi 100 m x 20 m trashësi prej betoni, duke përfshirë një portë dalëse dhe dy portat hyrëse.

(II) Një desandër, 1300 m² total dhe gjatësi 96 m, mure të izoluar me perimetër 220 m, përfshirë edhe 6 porta hyrëse dhe 3 porta dalëse.

(III) Një kanal ujëmbledhës me një gjatësi 100 m x 3.7 m gjerësi x 3.1 m thellësi, përfshirë aksesin në kanal prej 26 m.

(IV) Një tunel me gjatësi totale 4000 m dhe pamje mesatare 11 m².

(V) Një pellg ballor prej betoni rreth 150 m³, duke përfshirë një portë dalëse dhe një portë emergjente.

(VI) Një tubacion (GRP), me gjatësi 1 220 m, me diametër 2.4 m; tubacion me gjatësi 1250 m, me diametër 2.2 m dhe një tubacion me gjatësi 1200 m, me diametër 2 m.

(VII) Një godinë centrali me sipërfaqe rreth 220 m², duke përfshirë të gjitha pajisjet elektrike dhe elektromekanike, që përfshijnë 2 turbina, 3 gjeneratorë, 2 valvula gj, një sistem që anashkalon me një valvul, kompartimentet e tensionit të lartë, tensionit të ulët dhe sistemin e kontrollit.

(VIII) Një kanal uji me rreth 981m gjatësi dhe 14 m gjerësi, bërë me beton.

(IX) Një lidhje në rrjet e përbërë nga 2 kabllot e energjisë, një transformator TM/TL 110 kV dhe një N/st komutimi (vendi dhe zona do të përcaktohen gjatë punimeve).

VENDIM

Nr. 90, datë 7.6.2017

MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË PËRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA “ALBGAZ” SHA PËR PERIU DHËN 5.1.2017 – 20.9.2017

Në mbështetje të neneve 13 pika 2, 17 pika 1, germa “e”, dhe 33 të ligjit nr. 102/2015 “Për

sektorin e gazit natyror”, nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 19 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Çmimeve dhe Tarifave në lidhje me “Miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror për periudhën 5.1.2017 - 20.9.2017”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.12.2016 “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe përcaktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a.”.

- ERE, me vendimin nr. 82, datë 26.5.2017, vendosi certifikimin paraprak të shoqërisë “Albgaz” sh.a., si Operator i Kombinuar i gazit natyror në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet përkatëse të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

- Me anë të shkresës nr. 4, datë 20.2.2017, “Albgaz” sh.a. ka paraqitur në ERE kërkesën për miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror, bazuar në ligjin 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe VKM 848, datë 7.12.2016, ku kërkon:

1. Për periudhën 5.1.2017 - 20.2.2017, tarifa e transmetimit të gazit natyror të jetë 15.27 lekë/m³ me TVSH (pa TVSH, 12.725 lekë/m³), tarifë kjo e rënë dakord me shoqërinë “Albpetrol” sh.a.

2. Për periudhën 20.2.2017 - 20.9.2017, tarifa e transmetimit të gazit natyror të jetë 40 lekë/m³ me TVSH (pa TVSH, 33.33 lekë/m³).

- ERE, me shkresën nr. 167/1, datë 28.2.2017, i kërkoj shoqërisë “Albgaz” sh.a. informacion të detajuar dhe argumentet përkatëse në lidhje me kostot e shërbimit të transmetimit të gazit natyror në zbatim të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

- Me anë të shkresës nr. 93/4, datë 13.3.2017, shoqëria “Albgaz” sh.a. paraqiti në ERE informacion shtesë për të argumentuar kërkesën për tarifë.



- ERE, në datë 29.3.2017, zhvilloi seancë dëgjimore me palët shoqëria “Albgaz” sh.a. dhe shoqërinë “Albpetrol” sh.a., me qëllim qartësimin e kërkesave në lidhje me aplikimin për tarifën e transmetimit të gazit natyror.

- U organizua një seancë dëgjimore në datë 19.5.2017, midis përfaqësuesve të shoqërive “Albgaz” sh.a. dhe “Albpetrol” sh.a., në të cilën u kërkua opinion nga shoqëria “Albpetrol” sh.a. për dakordësinë apo kontestim në lidhje me tarifën e transmetimit të propozuar nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për vitin 2017.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. prej 25 lekë/m³, për periudhën 5.1.2017 - 20.9.2017.

2. Përditësimi dhe kompensimi i të gjitha efekteve të mundshme financiare për shoqërinë “Albgaz” sh.a. për periudhën 5.1.2017 - 20.9.2017 do të bëhet në periudhën pasardhëse sipas përcaktimeve të nenit 17, pika “e” të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

3. Drejtoria Çmimeve dhe Tarifave të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 112 lekë